



KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE E TË LIRIVE TË NJERIUT
COUNCIL FOR THE DEFENCE OF HUMAN RIGHTS AND FREEDOMS

Rr. Nëna Terezë nr. 24/2 – I/I, Prishtinë-Kosovë; tel. 381 (0) 249006 fax: 381 (0) 38 244029

E-mail: kmdl原因@gmail.com; <http://www.cdhrf.org>

Reagim i KMDLNj-së:

KMDLNj viziton stafin e Drejtorisë së Arsimit të Prishtinës e që janë në grevë!

KMDLNj – së, zyrës në Prishtinë i janë drejtuar zyrtarë të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prishtinë duke deklaruar se ndaj tyre po zbatohet një trajtim diskriminues dhe i pabarabartë gjatë caktimit të koeficientit të pagës. Me të njejtën deklaratë i ishin drejtuar Kryetarit të Prishtinës, z. Shpend Ahmeti dhe z. Mahir Yagcilar, ministër i Ministrisë së Administratës Publike. Këto shqetësime zyrtarët nga Drejtoria e Arsimit ia kanë shprehur gjatë takimeve me zyrtarë të lartë shtetërorë të cilët kanë premtuar se do t'i realizojnë kërkesat e tyre por deri më tani kur janë në grevë nuk kanë marrë përgjigje pozitive. Sipas ligjeve në fuqi zyrtarët e lartë e kanë koeficientin 8 kurse zyrtarët e DKA paguhen në bazë të koeficientit 6 që është diskriminim flagrant (Ligji për Paga, Ligji i Punës dhe Ligji për Shërbyes Civil). Ky diskriminim (mos'harmonizim i koeficientit të pagës) është edhe brenda komunës së Prishtinës si dhe brenda vet DKA – së. Për sqarim në konkurset e shpallura nga Komuna e Prishtinës pranohen zyrtarë të lartë me koeficientin e pagës 8. Pastaj, është evidente se ka shpërputhje të madhe dhe dallime në paga midis zyrtarëve të DKA të Prishtinës dhe komunave tjera për faktin se nuk paguhen njejtë për punën e njejtë që e bëjnë edhe në rast se kanë pozita dhe përgjegjësi të njejtë të punës e që është në kundërshtim të plotë me dispozitat e legjislationit të Shërbimit Civil përkatësisht nenit 3, paragrafi 2 të Ligjit nr.03/L147, për pagat e nënpunësve civil i cili thekson: "institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njejtë për punën me vlerë të njejtë...".

Në bazë të dokumentacionit që e ka në dispozicion e që ka të bëjë me trajtimin e kërkesës së zyrtarëve të DKA të Prishtinës për nivelizimin e koeficientit të pagës që tash janë në grevë në objektet e Komunës së Prishtinës (lagjia Arbëria) , KMDLNj vlerëson se këta zyrtarë po diskriminohen dhe po trajtohen në mënyrë të pabarabartë që përveç se është shkelje e ligjeve në fuqi, është edhe shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut që në rastin konkret duhet të mbrohen me Ligjin për Paga të Shërbyesve Civil dhe Ligjin e Punës. KMDLNj përkrah kërkesat e drejta të zyrtarëve të DKA të Prishtinës dhe kërkon që kërkesa e tyre të trajtohet me urgjencë dhe të bëhet nivelizimi i koeficientit të pagës në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

Së shpejti KMDLNj do të ketë takim me autoritetet përkatëse në mënyrë që kjo çështje të zgjidhet pa e dëmtuar procesin arsimor në komunën e Prishtinës, me ç' rast do ta pësojnë ata që më së shumti përfitojnë nga ky proces e ata janë nxënësit e të gjitha niveleve të arsimit.